

# KODI I SJELLJES PËR FURNIZUESIT E "DHL GROUP"

"DHL Group" është kompania lider e logjistikës në botë. Grupi bashkon njerëzit dhe tregjet dhe lehtëson tregtinë globale. Ai aspiron të jetë zgjedhja e parë e klientëve, punonjësve dhe investitorëve në mbarë botën. "DHL Group" përfshin dy marka të fuqishme: DHL ofron një gamë gjithëpërfshirëse të shërbimeve të transportit të pakove dhe transportit ndërkombëtar ekspres, transport mallr ash dhe shërbime të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit, si dhe zgjidhje logjistike të tregtisë elektronike. "Deutsche Post" është ofruesi lider i shërbimeve postare dhe të transportit të pakove në Evropë. Grupi jep kontributin e tij në botë, duke marrë masa për të minimizuar gjurmën e tij në mjedis, për të siguruar një mjedis pune të sigurt, përfshirës dhe angazhues, për të mbështetur komunitetet ku ai vepron dhe për të ndjekur praktika biznesi të besuara, transparente dhe të pajtueshme.

Ne jemi plotësisht të vetëdijshëm për përgjegjësitë që burojnë nga veprimtaritë tona, ndaj kemi vendosur një grup standardesh të rrepta etike që udhëheqin praktikatat tona të biznesit.

Ne presim që të gjithë furnizuesit tanë, duke përfshirë edhe nënkontraktorët, pra të gjitha shoqëritë që përfshihen në marrëdhënie biznesi me shoqëritë apo departamentet e "DHL Group", të përmbushin të njëjtat standarde etike. Për këtë qëllim, "DHL Group" ka hartuar këtë Kod Sjelljeje për Furnizuesit, i cili përcakton standardet minimale të të bërit biznes me shoqëritë ose Njësitë e Biznesit të Grupit.

## LIGJET DHE STANDARDET ETIKE



Furnizuesi vepron në pajtim me të gjitha ligjet e zbatueshme për aktivitetin e tij. Furnizuesi respekton parimet e Kompaktit Global të Kombeve të Bashkuara, Deklaratën Universale të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Parimet e OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, Udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe dhe Deklaratën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë, të vitit 1998, në përputhje me praktikën dhe ligjet e brendshme. Kjo vlen veçanërisht për:

## TË DREJTAT E NJERIUT DHE PRAKTIKAT E DREJTA TË PUNËS



### PUNA E TË MITURVE



Furnizuesi nuk punëson fëmijë nën moshën ligjore për punësim në asnjë shtet apo juridiksion lokal. Furnizuesi vendos moshën 15 vjeç si moshë minimale për punësim, edhe kur legjislacioni vendas lejon punësimin e të miturve në moshë më të vogël. Punonjësit nën moshën 18 vjeç lejohet të punojnë vetëm në përputhje me kërkesat ligjore të shtetit të tyre të punësimit (si p.sh. në lidhje me orarin dhe kushtet e punës) dhe sipas kërkesave që lidhen me arsimin ose formimin.

### PUNA E DETYRUAR



Furnizuesi nuk shfrytëzon asnjë formë të punës së detyruar, punës së imponuar për shlyerjen e borxheve, punës së detyrueshme apo forma moderne të skllavërisë. Çdo punë duhet të kryhet me vullnet të lirë. Punonjësit duhet të lejohen të kenë kontroll mbi dokumentet e tyre të identifikimit (si p.sh. pasaporta, leje pune apo dokumente të tjera ligjore personale). Furnizuesi sigurohet që punonjësit të mos paguajnë tarifa apo të mos kryejnë pagesa që lidhen me përfitimin e punësimit gjatë procesit të rekrutimit dhe periudhës së punësimit. Furnizuesi është përgjegjës për shlyerjen e të gjitha tarifave dhe shpenzimeve (p.sh. licenca dhe tatime) në lidhje me punonjësit, kur kjo kërkohet me ligj.

Ndëshkimi, imponimi me anë të dhunës mendore dhe/ose fizike dhe format e tjera të trafikimit të qenieve njerëzore janë të ndaluara. Politikat dhe procedurat disiplinore përcaktohen qartë dhe u komunikohen punonjësve.



### **PAGA DHE ORARI I PUNËS**

Furnizuesi vepron në pajtim me të gjitha ligjet vendase në fuqi dhe standardet e detyrueshme të industrisë në lidhje me orarin e punës, duke përfshirë edhe punën jashtë orarit, pushimet e vogla gjatë ditës së punës dhe lejet e paguara.

Furnizuesi i paguan punonjësit e tij në përputhje me legjislacionin vendas për pagën minimale dhe kushtet e kontratave kolektive të zbatueshme, si dhe në përputhje me standardet e industrisë. Furnizuesi i paguan punonjësit në kohën e duhur dhe u komunikon qartë bazën mbi të cilën llogaritet paga e tyre (pra, punonjësit i marrin dokumentet e punësimit në një gjuhë që ata e kuptojnë). Ndalohen zbritjet nga paga si masë disiplinore nëse nuk kjo nuk lejohet me ligj.



### **LIRIA SINDIKALE DHE BISEDIMET KOLEKTIVE**

Punonjësit e furnizuesit duhet të jenë të lirë t'i bashkohen ose jo një sindikate/organizate të përfaqësimit të punonjësve të zgjedhur prej tyre, pa iu nënshtruar kërcënimeve ose kanosjeve. Furnizuesi njih dhe respekton të drejtën për bisedime kolektive në përputhje me ligjet vendase në fuqi.



### **DIVERSITETI DHE PËRFSHIRJA**

Furnizuesi nxit krijimin e një mjedisi pune përfshirës, që e vlerëson diversitetin e punonjësve të tij.

Furnizuesi merr përsipër të ofrojë mundësi të barabarta dhe të mos diskriminojë apo të mos lejojë diskriminimin apo ngacmimin për shkak të gjinisë, origjinës etike dhe kombësisë, racës, ngjyrës, fesë, moshës, aftësisë së kufizuar, orientimit dhe identitetit seksual apo çdo karakteristike tjetër të mbrojtur me ligj.



### **SHËNDETI DHE SIGURIA**

Ne presim që furnizuesit tanë të përpiqen të zbatojnë standarde të larta të shëndetit dhe sigurisë në punë, duke aplikuar një qasje të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të përshtatshme për biznesin.

Furnizuesi respekton rregulloret e zbatueshme për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe krijon një mjedis pune të sigurt dhe që favorizon shëndetin e mirë, si p.sh. përmes ofrimit të ujit të pijshëm, në mënyrë që të ruajë sigurinë dhe shëndetin e punonjësve, të mbrojë palët e treta dhe të parandalojë aksidentet, lëndimet dhe sëmundjet që lidhen me punën. Kjo përfshin vlerësimet e rregullta të rrezikut në vendin e punës dhe zbatimin e masave të përshtatshme parandaluese dhe të kontrollit të rrezikut, duke përfshirë ofrimin e Pajisjeve të Përshtatshme të Mbrojtjes Personale (PMP). Punonjësit duhet të marrin njohuritë dhe trajnimin e duhur mbi çështjet e shëndetit dhe sigurisë, në një gjuhë që ata e kuptojnë.



### **MBROJTJA E TË DHËNAVE, SIGURIA E INFORMACIONIT DHE NXJERRJA E INFORMACIONIT**

Furnizuesi respekton ligjet e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave, duke përfshirë sigurinë e të dhënave personale, si dhe rregulloret përkatëse, si p.sh. GDPR-ja, veçanërisht për sa u përket të dhënave personale të klientëve, konsumatorëve, punonjësve dhe aksionarëve. Furnizuesi respekton të gjitha kërkesat në fjalë lidhur me mbledhjen, regjistrimin, ruajtjen, përpunimin, transmetimin, përdorimin ose fshirjen e të dhënave personale.

Kërkesat e sigurisë së informacionit që zbatohen për furnizuesit në lidhje me të dhënat e kontrolluara prej tyre gjatë dhe pas marrëdhënies së tyre me "DHL Group" bazohen në standardet ndërkombëtare, siç është Kodi i Praktikës për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit. Furnizuesit marrin në konsideratë nevojën për mbrojtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit. Niveli i kërkuar i sigurisë dhe kontrollit të informacionit që duhet të garantohet nga furnizuesit duhet të jetë në çdo kohë në përputhje me sensitivitetin, vlerën dhe rëndësinë e informacionit që përpunohet gjatë të gjithë ciklit jetësor të informacionit.

Furnizuesi ruan informacionin konfidencial dhe e përdor atë vetëm për qëllimin e caktuar. Furnizuesi respekton çdo kërkesë kontraktuale për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e informacionit dhe nuk nxjerr asnjë informacion që nuk është në dijeninë e publikut të gjerë.

## **RYSHFETI DHE KORRUPSIONI**



Furnizuesi vepron në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare të zbatueshme për luftën kundër korrupsionit. Furnizuesi nuk ofron, jep apo pranon (qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë) asnjë send me vlerë për të influencuar në mënyrë të paligjshme një akt zyrtar ose për të siguruar një përfitim të jashtëligjshëm për krijimin ose ruajtjen e marrëdhënieve të biznesit. Kjo përfshin të ashtuquajturat pagesa lehtësuese ose përfitime të tjera që u ofrohen funksionarëve publikë për kryerjen e veprimeve jodiskrecionale rutinë.

## **RREGULLAT PËR TREGTINË**



Furnizuesi vepron në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme për kontrollin e eksportit, sanksionet dhe doganat, duke përfshirë Ndalimet dhe Kufizimet ("Ligjet për tregtinë"). Furnizuesi sigurohet në veçanti që ai vetë, pronari (ët) i/e tij përfitues, të gjithë agjentët e tij dhe çdo nënkontraktor tjetër i përdorur prej tij të mos jenë të listuar në asnjë listë të zbatueshme sanksionesh për Palët e mohuara.

## **PASTRIMI I PARAVE DHE REGJISTRAT FINANCIARË**



Furnizuesi vepron në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi që synojnë të luftojnë veprimtaritë e pastrimit të parave. Furnizuesi mban regjistra dhe raporte financiare në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

## **KONKURRENCA E LIRË**



Furnizuesi vepron në pajtim me ligjet e zbatueshme për konkurrencën dhe antitrust-in.

## **KONFLIKTET E INTERESIT**



Konflikt interesi është çdo interes personal ose financiar, çdo veprimtari apo marrëdhënie biznesi ose personale, çdo punësim i mëparshëm ose aktual, ose çdo detyrim që mund të cenojë aftësinë për të kryer me objektivitet detyrat dhe përgjegjësitë e punës ose që mund të komprometojë paanshmërinë dhe objektivitetin. Rastet e konfliktit të interesit përfshijnë marrëdhëniet e ngushta, si p.sh. lidhjet e gjakut ose martesën, partneritetin dhe pjesëmarrjen ose investimin në partnerë ose konkurrentë të biznesit. Furnitori do ta deklarojë menjëherë çdo konflikt real ose të mundshëm të interesit që ka të bëjë me veprimtaritë e tij pranë "DHL Group".

## **MJEDISI**



Furnizuesi vepron në pajtim me të gjitha ligjet, rregulloret dhe standardet e zbatueshme mjedisore, si dhe zbaton një sistem efikas për identifikimin dhe eliminimin e rreziqeve të mundshme ndaj mjedisit.

Ne presim që, përmes produkteve dhe shërbimeve që ata ofrojnë, furnizuesit tanë të përpiqen të mbështesin angazhimet e "DHL Group" ndaj mbrojtjes së mjedisit dhe klimës, gjë që duhet bërë në mënyrë efikase duke marrë në konsideratë ndikimet në mjedis.

"DHL Group" pret gjithashtu që furnizuesit e tij të raportojnë të dhënat përkatëse mbi mbrojtjen e mjedisit dhe të klimës, kur kjo u kërkohet.

Ne presim që furnizuesit tanë ta marrin në konsideratë siç duhet mbrojtjen e mjedisit dhe të klimës në operacionet e tyre, si për shembull duke i vendosur vetes objektiva të mbrojtjes së klimës dhe duke i arritur ato.

## **MINERALET NË ZONAT E KONFLIKTIT**



Furnizuesit veprojnë në pajtim me të gjitha ligjet në fuqi dhe detyrimet rezultuese të vigjilencës së duhur në lidhje me nxjerrjen e mineraleve dhe materialeve nga rajonet e prekura nga konflikti dhe nga zona me rrezikshmëri të lartë, çka mund t'u japë shkas shkeljeve të të drejtave të njeriut, korrupsionit, financimit të grupeve të armatosura ose pasojave negative të ngjashme.

## **PËRFSHIRJA NË KOMUNITET**



"DHL Group" nxit furnizuesit të kontribuojnë në komunitetet e tyre lokale dhe të përfshihen në nisma dhe aktivitete që pasqyrojnë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së.

## PLANIFIKIMI PËR VIJIMËSINË E AKTIVITETIT



Furnizuesi është i përgatitur për çdo ndërprerje të aktivitetit të tij (p.sh. për shkak të fatkeqësive natyrore, terrorizmit, ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit, përhapjes së sëmundjeve të transmetueshme - epidemive ose pandemive, problematikave të sigurisë së informacionit, sulmeve kibernetike etj.). Kjo gatishmëri përfshin planet e vijimësisë së aktivitetit që mbrojnë si punonjësit ashtu edhe mjedisin nga pasojat e ndërprerjeve të rënda që mund të ndodhin në fusha të caktuara të operacioneve.

## DIALOGU ME PARTNERËT E BIZNESIT



Vetë furnizuesi, në marrëdhëniet kontraktuale me furnizues të tjerë, duhet të vendosë standarde të barasvlershme, si për shembull standardet etike, me ato të përcaktuara në këtë dokument, si pjesë e përmbushjes së detyrimeve të tij kontraktuale.

## RESPEKTI DHE DETYRIMI PËR KUJDES



Të gjithë furnizuesit kanë detyrimin të veprojnë dhe ndërveprojnë me respekt dhe mirëbesim me punonjësit e "DHL Group".

Furnizuesit ushtrojnë kujdesin e duhur në përdorimin e pronës dhe pajisjeve që u janë besuar atyre, si të ishin pronë e atyre vetë.

Gjatë përdorimit të pronës ose materialeve që mbartin një markë tregtare apo brend të "DHL Group", të gjithë furnizuesit ushtrojnë kujdes të veçantë, pasi veprimet ose veprimtaritë e tyre mund të identifikohen me "DHL Group". Duhet të shmanget çdo përdorim i paautorizuar i materialeve apo pajisjeve të markës tregtare apo të brendit të "DHL Group". Edhe veprimet në dukje të parregullta do të konsiderohen si keqpërdorim i materialeve dhe pajisjeve të markës tregtare apo brendit të "DHL Group".

## RESPEKTIMI I KODIT TË SJELLJES PËR FURNIZUESIT



"DHL Group" rezervon të drejtën për të verifikuar respektimin e kërkesave të këtij Kodi Sjelljeje, si për shembull me anë të vetëvlerësimeve dhe kontrolleve të kryera nga "DHL Group" ose nga një palë e tretë. Furnizuesi bën përpjekje për përmirësim të vazhdueshëm, si për shembull me anë të vendosjes së objektivave të matshme lidhur me mjedisin, kushtet e punës ose diversitetin, si dhe duke raportuar mbi progresin drejt qëndrueshmërisë. Në rast të identifikimit të një shkeljeje, furnizuesi harton një raport për rastin dhe paraqet një plan masash korrigjuese.

Kushtet e përgjithshme të parashtuara në këtë Kod Sjelljeje për Furnizuesit pasqyrojnë vlerat dhe përkushtimin e "DHL Group" ndaj klientëve tanë, ndaj komuniteteve të cilave u shërbejmë dhe në drejtim të mbrojtjes së mjedisit. Për rrjedhojë, çdo shkelje e këtyre kushteve të përgjithshme duhet të korrigjohet. Pa cenuar mjetet e tjera kontraktuale të ankimit që DHL Group-ja mund të ketë të drejtën të përdorë, çdo moskorrigjim i menjëhershëm i një shkeljeje të tillë do të rezultojë në marrjen në konsideratë të përfundimit të marrëdhënies tregtare nga ana e "DHL Group".

## RAPORTIMI I PARREGULLSIVE



Në rast se dëshironi të raportoni shkelje të mundshme të ligjit ose të dispozitave të këtij Kodi Sjelljeje, mund të kontaktoni Menaxhimin e Pajtuëshmërisë të "DHL Group" përmes kësaj lidhjeje <https://www.dpdhl.com/en/about-us/code-of-conduct/compliance-management/compliance-contact.htm>

## PËRMIRËSIMI I VAZHUESHËM



Furnizuesi inkurajohet të shprehë në mënyrë proaktive pranë "DHL Group" ide novatore që kontribuojnë në përmirësime të mëtejshme sociale, ekonomike ose mjedisore. "DHL Group" vlerëson shkëmbimin e hapur të ideve të reja dhe është i gatshëm të shqyrtojë mundësi të reja së bashku me furnizuesit.